REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Nr.____Prot. Tiranë, më ___/___/2023

TERMAT E REFERENCËS

PËR OBJEKTIN:

"SHËRBIME INXHINIERIKE TË PAVARURA PËR ZBATIMIN E KONTRATËS KONCESIONARE/PPP PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, DHE MIRËMBAJTJEN E "PORTIT TË INTEGRUAR" NË TRIPORT, VLORË"

Qëllimi i përgjithshëm

Inxhinieri i Pavarur (**IP**) do të mbikëqyrë dhe monitorojë zbatimin Kontratës Koncesionare/PPP për Projektimin, Ndërtimin dhe Mirëmbajtjen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë**.**, miratuar me VKM nr. 299, datë 11.5.2022.

Inxhinierit të pavarur i kërkohet të ofrojë ekspertizë në të gjitha fushat e Koncesionit pa përjashtim. Çdo aspekt i ecurisë së Koncesionit duhet t'i nënshtrohet certifikimit në bazë të Sistemeve të tij të cilësisë dhe auditimit sa i takon cilësisë në lidhje me rezultatet e Koncesionarit me cilësi të siguruar dhe kontrolluar.

Roli kryesor i IP do të përfshijë të gjitha funksionet e përgjithshme dhe specifike dhe përgjegjësitë të cilat janë të përcaktuara në Kontratën e Koncesionit/PPP, si dhe çdo funksion apo përgjegjësi që nuk mund të specifikohen.

Objekti i shërbimeve dhe shkalla e të drejtave dhe detyrave të Inxhinierit të pavarur janë në përputhje me kontratën që do të lidhet midis Autoritetit Kontraktor dhe Inxhinierit të Pavarur, e cila përmban detyrat kryesore të Inxhinierit të Pavarur të përcaktuara në Shtojcën 8.

Shtojca 8 [cit]. "*Në përgjithësi, roli i Inxhinierit të pavarur duhet të zgjerohet për të mbuluar funksione për cilat Autoriteti Kontraktues nuk është plotësisht i pajisur. Inxhinierit të pavarur konsulent i kërkohet të ofrojë ekspertizë në të gjitha fushat e Koncesionit pa përjashtim. Çdo aspekt i ecurisë së Koncesionit duhet t'i nënshtrohet certifikimit në bazë të Sistemeve të tij të cilësisë dhe auditimit sa i takon cilësisë në lidhje me rezultatet e Koncesionarit me cilësi të siguruar dhe kontrolluar. Për këtë arsye dhe në mbështetje të funksioneve që duhet të kryejë Inxhinieri i pavarur duhet të sigurojë personel të mjaftueshëm, i cili duhet të zotërojë njohuritë*

e duhura të fushës. Si minimum, personeli i Inxhinierit të pavarur duhet të përfshijë specialitetet e mëposhtme:

1. *Kryeinxhinier*
2. *Inxhinier të materialeve*
3. *Inxhinier Gjeolog*
4. *Inxhinier gjeoteknik*
5. *Inxhinier strukturor*
6. *Inxhinier për sinjalistikën dhe mbrojtjen e sigurisë*
7. *Ekspert mjedisi*
8. *Specialist informatike*
9. *Inxhinier topograf*
10. *Inspektor për sigurinë dhe shëndetin në punë*
11. *Ekonomist*
12. *Jurist*

Përshkrimi i projektit

Porti i Integruar ne Triport, Vlorë parashikohet të ndërtohet 9 km në Veri-Lindje të qytetit të Vlorës dhe konkretisht në portin e peshkimit të këtij qyteti të quajtur "Triport".

Porti ndodhet në bregdetin Jugor të Shqipërisë, afërsisht 160 km në veri të kufirit tokësor me shtetin e Greqisë dhe konkretisht 167 km larg nga pika kufitare më e madhe me Greqinë që është Kakavia, 150 km (80 Nm) nga deti deri në Portin e Korfuzit dhe vetëm 90 km (50 Nm) nga rajoni i Puglias në Itali. Kufiri tokësor me Malin e Zi është afërsisht 244 km në veri të Vlorës, dhe hyrja në Gjirin e Kotorrit (gjithashtu formon kufirin tokësor midis Malit të Zi dhe Kroacisë) është 125 Nm me det.

Porti i Peshkimit "Triport" ndodhet rreth 3 km në veri të Portit të Vlorës, midis Terminalit të përpunimit të naftës dhe nënprodukteve të saj "Petrolifera Italo-Albanese) PIA dhe TEC Vlorë, ndërsa nga Juglindja kufizohet me Parkun Industrial Vlorë. Porti është i rrethuar nga pylli i Sodës ku në këtë zonë ndodhen edhe shumë aktivitete private kryesisht argëtimi në fushën e kulinarisë.

Aktualisht, Triporti është i ndarë në dy pjesë:

1. Pjesa e brendshme e portit (1), ku porti ofron kapacitete për shërbimin e anijeve të peshkimit. Ku porti është i mbrojtur nga të gjitha anët me dallgëthyes dhe infrastruktura është e amortizuar dhe kërkon masa emergjente për përmirësime;
2. Pjesa e jashtme e portit të peshkimit (2), e cila është hapësirë e fituar pas ndërtimit të dallgëthyesit. Në zbatim të Vendimit të Këshilli Kombëtar i Territorit në këtë zonë do të transferohen nga Porti i Vlorës edhe dy shërbimet e tjera: a) Transporti ndërkombëtar i pasagjerëve dhe automjeteve dhe b) Transporti kombëtar/ndërkombëtar i mallrave.

Plani i Përgjithshëm i objektit të koncesionit "Port i Integruar" në Triport - Vlorë është is më poshtë:

Objekti i punës

Objekti i punës së Inxhinierit të Pavarur do të bazohet në atë që përmbahet në **Shtojcën 8** të Kontratës së Koncesionit, miratuar me VKM nr. 299, datë 11.5.2022 "*Për Miratimin e Kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat, Për Projektimin, Ndërtimin dhe Mirëmbajtjen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë "Agbes Construcion" sh.p.k, "Besta" sh.p.k, "Premium Construction & Maintenance" sh.p.k, "ITE Grup" sh.p.k dhe "ArkonStudio" sh.p.k,*

Detyrat kryesore të Inxhinierit të pavarur

Inxhinieri i pavarur ndërmerr funksionet e mëposhtme:

I. Funksione të përgjithshme

1. Kryen kontrolle të përgjithshme, auditon dhe asiston në prova ose hetime në lidhje me Punimet ose Shërbimet, duke pasur në çdo moment liri të pakufizuar për të hyrë në çdo territor ose punishte ku prodhohen materiale, në varësi të ndjekjes së të gjitha procedurave përkatëse të sigurisë;
2. Mbikëqyr në aspektin teknikë, ekonomiko financiare dhe ligjore plotësimin nga Koncesionari të dispozitave të Kontratës së Koncesionit, me përshtatjet përkatëse që lejon Kontrata, dhe informon menjëherë Autoritetin Kontraktues dhe Koncesionarin nëse konstatohet mosplotësim;
3. Ka liri të pakufizuar hyrjeje në Territorin e Projektit në çdo moment të arsyeshëm gjatë të gjithë Periudhës së Kontratës në mënyrë që të kryejë funksionet e tij;
4. Ka të drejtë të hyjë në çdo pronë që përdor Koncesionari për realizimin e Punimeve dhe Shërbimeve, për të kontrolluar ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Projektit dhe për të ndjekur plotësimin e detyrimeve nga Koncesionari;
5. Ka të drejtë të hyjë në çdo moment në çdo pronë të përdorur nga Koncesionari si objekt trajnimi ose punishte dhe në vendet ku përgatitet puna ose nxirren materialet për Projektin, për të ndjekur plotësimin e detyrimeve nga Koncesionari;
6. Ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet ku diskutohet ecuria mujore ose me shpeshtësi tjetër në lidhje me Punimet dhe/ose Shërbimet dhe të marrë njoftim në kohën e duhur për këto mbledhje nga Koncesionari;
7. Ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë kopje të të gjitha skicave, lidhjeve, specifikimeve dhe shtojcave, pas çdo modifikimi që u bën Koncesionari;
8. Ka të drejtë t'i kërkojë Koncesionarit të ndreqë çdo defekt në plotësimin e detyrimeve në bazë të Kontratës dhe të vlerësojë se sa janë korrigjuar këto defekte;
9. Ka të drejtë t'i kërkojë Koncesionarit të largojë nga Territori i Projektit çdo agjent ose punëmarrës të Koncesionarit ose çdo Nënkontraktor të cilitdo niveli, sipas rastit, që, sipas mendimit të Inxhinierit të Pavarur, bën shkelje, është i paaftë ose tregon pakujdesi në kryerjen siç duhet të detyrave në lidhje me Projektin, ose prania e të cilëve konsiderohet e padëshirueshme në Territorin e Projektit;
10. Konsultohet me Palët për çdo çështje që ka të bëjë me Punimet dhe Shërbimet;
11. I jep raporte ose informacione Autoritetit Kontraktues;
12. Shqyrton shfuqizimin ose ndryshimin me ndikim negativ të të gjithave ose disave prej Dokumenteve të projektit dhe jep kundërshtimin e vet për këtë nëse është nevoja;
13. Sa herë i kërkohet të japë vendim, opinion ose pëlqim apo të shprehë bindjen ose aprovimin e tij ose të kryerje veprime të tjera që mund të prekin të drejtat dhe detyrimet e Palëve të përfshira ("Konstatim"), nëse nuk parashikohet ndryshe, Inxhinieri i pavarur e bën këtë Konstatim sapo ta ketë të mundur dhe në çdo rast brenda afatit të parashikuar në Kontratën

e Koncesionit dhe/ose në Kërkesat e Autoritetit Kontraktues sipas çështjes në fjalë dhe i komunikon komentet që mund të ketë në lidhje me këtë Konstatim brenda afatit përkatës;

14. Jep vlerësim mospranues për raportet që janë mbështetur në informacione ose të dhëna të gabuara ose që nuk janë në përputhje me këtë Kontratë;
15. Ka të drejtë të shikojë, auditojë dhe marrë kopje të evidencave të Koncesionarit në çdo moment;
16. E ndryshon adresën pasi i ka njoftuar Palët e përfshira.

II. Funksione të veçanta në lidhje me Aspektet e Kërkesave të Autoritetit Kontraktues dhe Kontratën e Koncesionit

A. Sistemi i menaxhimit të cilësisë:

a) Aprovon dhe jep komente për Manualin e kontrollit të cilësisë për ndërtimin dhe mirëmbajtjen.

b) Kqyr dhe auditon Sistemin e menaxhimit të cilësisë të Koncesionarit dhe planet e lidhura të cilësisë, përfshirë edhe ato të projektuesve, Nënkontraktorëve dhe furnitorëve të tij, në intervalet që i konsideron të arsyeshme Inxhinieri i Pavarur.

c) Shqyrton dokumentacionin e cilësisë në përputhje me standardin e kërkuar.

d) Aprovon dhe komenton për Sistemet përkatëse të cilësisë të hartuara nga Koncesionari përpara fillimit të çdo pjese të Punimeve ose Shërbimeve dhe përditësimet e tyre gjatë Periudhës së vlefshmërisë së Kontratës.

e) Merr pjesë së bashku me menaxherin e projektit të Koncesionit në kontrollet zyrtare dhe të parashikuara me grafik të niveleve të shërbimit që zhvillohen dhe që realizohen nga Njësia e Zbatimit të Projektit.

B. Sistemet e kontrollit, monitorimit dhe menaxhimit:

a) Këshillon për kohën e lejuar për riparimet e defekteve në rastet kur këto riparime janë të nevojshme dhe nuk mund të përfundohen brenda afatit kohor të dakordësuar të palëve;

b) Jep këshilla dhe orientime për kontrollet e strukturave në lidhje me përmbushjen e standardeve shqiptare dhe evropiane dhe të Praktikës së mirë të sektorit ekonomik, si edhe sistemin e menaxhimit të strukturave;

c) Aprovon projekt-propozimin e hollësishëm për zhvillimin dhe shfrytëzimin e sistemeve të menaxhimit të inventarit dhe infrastrukturës;

d) Aprovon/konfirmon demonstrimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit të inventarit dhe infrastrukturës;

e) Aprovon sistemet e menaxhimit me licencë të blerë;

f) Aprovon programin e kontroll-monitorimit për vitin e ardhshëm (përfshirë metodikën, format dhe procedurat) që është pjesë e raportit vjetor;

C. Punimet kapitale dhe Riparimet kapitale

1. Bashkërendon dhe mbikëqyr Punimet kapitale dhe/ose Riparimet kapitale, që merr përsipër Autoriteti Kontraktues dhe/ose nënkontraktori i Autoritetit Kontraktues gjatë kohëzgjatjes së Koncesionit, të cilave duhet t'u bëjë vend Koncesionari.
2. Jep rekomandime (shtesë) për standardet e projektimit që duhen përdorur në propozimet e reja si edhe në përgatitjen e të gjitha projekteve kryesore përfundimtare të elementeve të Punimeve kapitale nga Koncesionari.
3. Aprovon paketën e plotë të standardeve të projektimit për secilin element të Punimeve që ka përpiluar Koncesionari përpara fillimit të çdo projekti teknik kryesor përfundimtar.
4. Aprovon shmangiet nga standardet dhe normat e konfirmuara të projektimit, si edhe nga projektet paraprake dhe/ose të hollësishme, që mund të jenë me përfitim për Autoritetin Kontraktues dhe për Projektin sa i takon sigurisë, efikasitetit të shfrytëzimit, ekonomisë në ndërtim dhe mirëmbajtjes, programit të ndërtimit, jetëgjatësisë së përgjithshme, përmbushjes së standardeve të reja ndërkombëtare dhe harmonizimit me BE-në në të ardhmen.
5. Konfirmon miratimin e tij për propozim-projektin me shkrim me t'u arritur marrëveshja për këtë.
6. Shqyrton dhe aprovon shtesat dhe ndryshimet në propozim-projektin e pranuar të paraqitura nga Koncesionari si shtojca përpara fillimit të punës për aspektet e punimeve që preken nga shtojca në fjalë.
7. Kontrollon efektin që kanë Objektet e përkohshme tek struktura e përhershme (por nuk kontrollon Objektet e përkohshme).
8. Aprovon verifikuesin e pavarur të Objekteve të përkohshme.
9. Shqyrton vlefshmërinë e projektit dhe verifikon certifikatat e të gjitha Objekteve të përkohshme.
10. Shqyrton dhe pranon (ose refuzon) projektin e plotë përfundimtar për elementet e Punimeve kapitale që duhet të përfshijnë evidencat e plota të projektit të aprovuar.
11. Kërkon dhe përdor manualin e projektimit si tekst të plotë mbështetës dhe dokument efikas pune.
12. Komenton dhe aprovon programin e punës për projektet teknike të paraqitura nga Koncesionari për të gjitha elementet që përbëjnë Punimet kapitale.
13. Shqyrton propozim-projektet e paraqitura, në konsultim me Autoritetit Kontraktues. Pas përfundimit të shqyrtimit, Inxhinieri i pavarur:
    - ✓ aprovon materialin e paraqitur,
    - ✓ jep aprovim të kushtëzuar që kërkon bërjen dhe përfshirjen e rishikimeve në skicat e punës ose

- ✓ refuzon pjesërisht ose plotësisht materialin nëse konstaton se projekti teknik nuk i përmbush kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktues dhe/ose kriteret e projektimit.

14. Shqyrton skicat teknike të punës të paraqitura. Pas përfundimit të shqyrtimit, Inxhinieri i pavarur:
    - ✓ aprovon materialin e paraqitur,
    - ✓ refuzon pjesërisht ose plotësisht materialin nëse konstaton se projekti teknik nuk i përmbush kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktues dhe/ose kriteret e projektimit ose me komentet e bëra nga Inxhinieri i pavarur si pjesë e aprovimit të kushtëzuar të propozim-projektit.
15. Monitoron Punimet në përputhje me Kontratën e Koncesionit sipas klauzolës __.
16. Aprovon shmangien nga standardet dhe normat në lidhje me specifikimet teknike që është me përfitim për Autoritetin Kontraktues sa i takon sigurisë, efikasitetit të shfrytëzimit dhe jetëgjatësisë.
17. Merr dhe aprovon planin për menaxhimin e ndërtimit të Punëve kapitale për të gjitha Aspektet e punëve kapitale.
18. Aprovon programin e hollësishëm për projektimin dhe ndërtimin e punimeve për çdo Aspekt të punimeve kapitale të paraqitur nga Koncesionari.
19. Aprovon raportet mujore të ecurisë dhe përditësimet e programit sipas kërkesave.
20. Merr pjesë në procesin vjetor të konsultimeve dhe aprovimeve në lidhje me realizimin e Punimeve kapitale në bazë të datave të paracaktuara të fillimit dhe përfundimit (ose datave të kushtëzuara të fillimit dhe data përkatëse të përfundimit, sipas rastit).

D. Menaxhimi dhe vlerësimi i ecurisë:

a) Monitoron dhe raporton për ecurinë e Koncesionarit kundrejt kërkesave kontraktore në bazë të Relacioneve mujore/Relacioneve vjetore të ecurisë, planit të ndërtimit të Terminaleve dhe rrugëve, Manualit të mirëmbajtjes, Sistemeve të cilësisë dhe Sistemi i menaxhimit mjedisor që japin informacionet e nevojshme për drejtimin.

b) Ndërmerr auditime të palës së dytë të Sistemeve të cilësisë dhe disa auditime teknike të punimeve faktike.

c) Ndërmerr auditime teknike të Shërbimeve dhe Punimeve të monitoruara nga Njësia e dedikuar e kontrollit të cilësisë e Koncesionarit.

d) Ka të drejtë të rrisë, me shpenzimet e Koncesionarit, nivelin ose shpeshtësinë e monitorimit, auditimit, testimit dhe inspektimit të Portit dhe respektimit nga Koncesionari të detyrimeve të veta në bazë të kësaj Kontrate, në atë nivel që Autoriteti Kontraktues ose Inxhinieri i Pavarur e konsideron të përshtatshëm, sipas Kontratës së Koncesionit.

E. Kthimi:

1. Mund të udhëzohet nga Autoriteti kontraktues të kryejë një inspektim të Portit për të konstatuar nëse Koncesionari po i përmbush apo jo kërkesat e kësaj Kontrate dhe në veçanti nëse do të përmbushen Kërkesat për kthimin brenda Datës së përfundimit të vlefshmërisë.
2. Shqyrton dhe aprovon planin e vlerësimit për kthimin përpara fillimit të çdo pune nga Koncesionari.
3. Konsultohet me Koncesionarin në lidhje me përditësimin e planit të vlerësimit për kthimin sipas nevojës për të reflektuar ndryshimet e kushteve të aktiveve të projektit ose të metodikës së vlerësimit të përcaktuara pas inspektimit të Portit nga Autoriteti Kontraktues ose nga personi i caktuar prej tij.
4. Shqyrton dhe aprovon procedurat e hollësishme të testimit dhe inspektimit sipas kërkesave të kontratës.
5. Bashkërendon me Koncesionarin të gjitha aspektet e planit të punimeve rinovuese për kthimin.
6. Merr në dorëzim dokumentacionin nga Koncesionari ku bëhet e ditur se Koncesionari i ka përmbushur udhëzimet dhe i ka përmbushur dhe përfunduar detyrimet për çdo ndreqje siç e kërkon legjislacioni shqiptar në lidhje me ato fusha ku është dashur të merren masa ndreqëse për shkak kontaminimi apo derdhjeje lënde djegëse.
7. I asiston Koncesionarit në kryerjen e Vrojtimit përfundimtar për kthimin në mënyrë që të përcaktohet se çfarë punimesh ndreqëse kanë mbetur pa u bërë.

Funksione të tjera:

1. Certifikon që Trualli shtesë kërkohet nga Koncesionari për realizimin e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.
2. Jep opinion për pretendimet e Nënkontraktorëve dhe çdo dokument që lidhet me to. Aprovon dhe komenton Programin fillestar të Koncesionarit (ose shtesat dhe ndryshimet në të).
3. Kryen procedurën e dorëzimit teknik pas përfundimit paraprak.
4. Kontrollon dhe vërteton se janë përfunduar Punimet e nevojshme për shfrytëzimin pa rrezik të Portit.
5. Vlerëson rezultatin e procedurës së dorëzimit teknik dhe konstaton nëse Koncesionari i ka përmbushur të gjitha Kërkesat e Autoritetit Kontraktues për punimet, ose informon Koncesionarin për çdo kundërshtim.
6. Konsulton Koncesionarin me qëllim arritjen e një marrëveshjeje për masat që kërkohet të merren në mënyrë të arrihet përmbushja e Kërkesave të Autoritetit Kontraktues në rast se ka kundërshtim.
7. Kryen procedurën e dorëzimit teknik pas përfundimit përfundimtar.

8. Kontrollon dhe vërteton se Punimet janë përfunduar dhe se kushtet e përcaktuara në Certifikatën e përkohshme të Përfundimit janë përmbushur.

9. Përcakton se çfarë shtesash dhe ndryshimesh duhen bërë në Manualet e mirëmbajtjes në rast se Palët nuk merren vesh për shtesat dhe ndryshimet e duhura.

10. Përcakton shtesat dhe ndryshimet e duhura në Programin e riparimeve kapitale në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.

11. Konstaton nëse ka ndodhur ndonjë defekt, shkelje dhe/ose mosplotësim dhe afatin e ndreqjes në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit në lidhje me defektet e identifikuara dhe të nevojshme për t'u ndrequr.

12. Vendos për Truall shtesë alternativ të ngjashëm nëse Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari nuk mund të merren vesh.

13. Informohet dhe vepron sipas nevojës në përputhje me Kontratën e Koncesionit sa u takon ngjarjeve të kompensimit.

14. Vlerëson dëshmitë që jep koncesionari sa u takon ngjarjeve të kompensimit.

15. Informohet dhe vepron sipas nevojës në përputhje me Kontratën e Koncesionit sa u takon ngjarjeve të lehtësimit nga detyrimi.

16. Vlerëson dëshmitë që jep koncesionari sa u takon ngjarjeve të lehtësimit nga detyrimi.

17. Informohet dhe vepron sipas nevojës në përputhje me Kontratën e Koncesionit sa u takon ngjarjeve të forcës madhore.

18. Vlerëson dëshmitë që jep koncesionari sa u takon ngjarjeve të forcës madhore.

19. Njoftohet me shkrim për pasojat e mundshme të një Ndryshimi cilësues të ligjit që është bërë ose do të bëhet shumë shpejt.

20. Njoftohet pa vonesë të panevojshme për kërkesën e Koncesionarit për të marrë përfitime pas hyrjes në fuqi të Ndryshimit cilësues të ligjit.

21. I vihet në dispozicion një shpjegim i plotë dhe i hollësishëm dhe dëshmi në lidhje me Ndryshimin cilësues të ligjit dhe përfitimet e kërkuara, kohëzgjatjen e çmuar të vonesës në fjalë, çdo informacion përkatës që ka të bëjë me Ndryshimin cilësues të ligjit dhe humbjen e pritur të të ardhurave ose rritjen e kostove që vjen nga Ndryshimi cilësues i ligjit.

22. Ofron marrje vendimi në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit në lidhje me një Ndryshim të Autoritetit Kontraktues të kërkuar në përputhje me klauzolën ____ të Kontratës së Koncesionit (Ndryshime të punimeve dhe shërbimeve).

23. Jep opinion për arsyeshmërinë e propozimeve të Koncesionarit në Njoftimin për ndryshim.

24. Ofron marrje vendimi nëse është i nevojshëm Plani i restaurimit dhe kur është i nevojshëm ky plan.

Afati

Në nenin 20 "**Ndërtimi**", të Kontratës së Koncesionit, pika 20.7 "**Inxhinieri i Pavarur**", nënpika 20.7.2 përcaktohet se: "*Autoriteti Kontraktor e kontrakton Inxhinierin e Pavarur brenda 6 (gjashtë) Muajsh nga Data e Hyrjes në Fuqi e kēsaj Kontrate dhe përzgjedhja e tij bëhet në përputhje me Ligjin shqiptar për Prokurimet Publike. Kontrata fillestare e Inxhinierit të Pavarur bëhet për një kohë deri në mbarim të Periudhës së Përgjegjësisë për Defektet e Punimeve (periudha e garancisë së Punimeve sipas parashikimeve të kësaj Kontrate). Më pas, çdo Kontratë e Inxhinierit të Pavarur duhet të jetë të paktēn pēr një periudhë maksimale qē parashikon legjislacioni shqiptar pēr prokurimet publike.*";

Kriteret të cilat do të përzgjidhet Inxhinieri i Pavarur

Inxhinierit të pavarur konsulent i kërkohet të ofrojë ekspertizë në të gjitha fushat e Koncesionit pa përjashtim. Çdo aspekt i ecurisë së Koncesionit duhet t'i nënshtrohet certifikimit në bazë të Sistemeve të tij të cilësisë dhe auditimit sa i takon cilësisë në lidhje me rezultatet e Koncesionarit me cilësi të siguruar dhe kontrolluar. Për këtë arsye dhe në mbështetje të funksioneve që duhet të kryejë Inxhinieri i pavarur duhet të sigurojë personel të mjaftueshëm, i cili duhet të zotërojë njohuritë e duhura të fushës.

Personeli i Inxhinierit të pavarur, pa u kufizuar, duhet të përfshijë specialitetet e mëposhtme:

NR.	STAF I REKOMANDUAR I NEVOJSHEM I IP	KUALIFIKIME	Eksperience Profesionale
1	Drejtues projekti	Master (3+2) ose ekuivalent në Inxhineri Ndërtimi/Arkitekture	20
2	Inxhinier Terreni	Master (3+2) ose ekuivalent në Inxhineri Ndërtimi	15
3	Inxhinier Materiali	Master (3+2) ose ekuivalent në Inxhineri Ndërtimi/Materialesh	15
4	Inxhinier Mjedisi	Master (3+2) ose ekuivalent në Inxhineri Ndërtimi/Mjedisi/dega mjedis e Universitetit Bujqësor	15
5	Inxhinier Gjeodet	Master (3+2) ose ekuivalent në profilet Inxhinier Gjeodet/Inxhinier Topograf/Inxhinier Markshajder/Inxhinier Gjeomatik.	15
6	Inxhinier Gjeolog	Master (3+2) ose ekuivalent në profilet Gjeologji Inxhinierike/Hidrogjeologji	20
7	Inxhinier Gjeoteknik	Master (3+2) ose ekuivalent në Inxhineri Gjeoteknike-Profili Gjeoteknikë	20
8	Inxhinier Elektronik/Specialist Informatike	Master (3+2) ose ekuivalent në Inxhineri Elektronike, Informatike (Teknologji Informacioni)	10
9	Inxhinier Elektrik	Master (3+2) ose ekuivalent në Inxhineri Elektrike/Elektronike	15
10	Inxhinier per Sinjalistiken dhe Sigurine Rrugore	Master (3+2) ose ekuivalent në Inxhineri Ndërtimi/Infrastrukturë e Transportit/ Inxhinier Ndërtimi i diplomuar në degën Inxhinier për ndërtime qytetare industriale përpara vitit 1971/në profilin e Inxhinierit Mekanik në Infrastrukturë e Transportit ose në Planifikimin e Sistemeve të Transportit, Trafikut e Sigurisë Rrugore.	15
11	Inxhinier Strukturor	Master (3+2) ose ekuivalent në Inxhineri Ndërtimi (përjashtuar profilin e Infrastrukturës së Trasportit dhe profilin Hidroteknik)	15
12	Inspektor per Sigurine dhe Shendetin (HSE)	Master (3+2) ose ekuivalent në Inxhineri - Ndërtim/Mjedis/etj. ...	15
13	Ekonomist	Master (3+2) ose ekuivalent në Shkenca Ekonomike	5
14	Jurist	Master (3+2) ose ekuivalent në Shkenca Juridike	5
	Shënim:		
	Në çdo rast duhet ti referohemi **LIDHJES 5** të VKM nr. 943, datë 28.12.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim".		

Roli i Inxhinierit të pavarur është certifikimi i pavarur i punës konform kërkesave dhe që çdo punë bëhet nëpërmjet sigurimit të cilësisë/kontrollit të cilësisë të Koncesionarit, sic mund të jetë e nevojshme herë pas here, në përputhje me udhëzimet ekzekutive të Autoritetit Kontraktues për të konfirmuar dhe/ose korrigjuar ecurinë.

Inxhinieri i pavarur mbikëqyr dhe kontrollon, nëpërmjet Sistemeve të veta të cilësisë, ecurinë e Koncesionarit. Inxhinieri i pavarur kryen auditim të kontrollit të cilësisë sipas nevojës (në bazë të variancës statistikore të ecurisë së Koncesionarit), për të konfirmuar certifikatën e përputhshmërisë të Koncesionarit.

Nëse certifikata e Inxhinierit të pavarur për punën e Koncesionarit, si për Koncesionarin ashtu edhe për Autoritetin Kontraktues, thotë se ka mosplotësim, atëherë Sistemet e cilësisë të Koncesionarit duhet të diktojnë që puna të korrigjohet/përsëritet.

MODEL

FORMULAR OFERTE

NR.	PERSHKRIMI	PERIUDHA E SHERBIMIT (MUAJ)	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
	Lista e Ekspertëve					
1	Drejtor projekti	48	Staf/Muaj	100%		
2	Inxhinier Terreni	48	Staf/Muaj	100%		
3	Inxhinier Materiali	48	Staf/Muaj	100%		
4	Inxhinier Gjeolog	48	Staf/Muaj	80%		
5	Inxhinier Gjeoteknik	48	Staf/Muaj	100%		
6	Inxhinier Strukturist	48	Staf/Muaj	80%		
7	Inxhinier për Punimet e Sinjalistikës dhe Sigurisë Rrugore	48	Staf/Muaj	100%		
8	Inxhinier Mjedisi	48	Staf/Muaj	100%		
9	Inxhinier Elektronik/Informatike/IT	48	Staf/Muaj	80%		
10	Inxhinier Gjeodet	48	Staf/Muaj	100%		
11	Specialist HSE	48	Staf/Muaj	100%		
12	Inxhinier Elektrik	48	Staf/Muaj	80%		
13	Ekonomist	48	Staf/Muaj	20%		
14	Jurist	48	Staf/Muaj	25%		
Shuma 1						
	Shpenzime					
1	Shpenzime zyre (…)	48				
2	Shpenzime stafi (…)	48				
3	Shpenzime të tjera të paparashikuara (…)	48				
Shuma 2						
Shuma 1+2						
TVSH 20%						
TOTALI						

Lidhur me përgatitjen e kritereve teknike, grupi i punës mbështetur në:

Në nenin 15, pika 3, gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", *i ndryshuar*, përcaktohet se dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik. "*3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve: ... c) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:*

- *termat e referencës;*
- *grafikun e ekzekutimit;*
- *kërkesat për personelin kryesor;*
- *kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.*"

Në nenin 74, pika 3, gërma ç) e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", *i ndryshuar* përcaktohet "*Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme: ... ç) Përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre; ...*"

Neni 78, përcaktohet "*1. Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. ... . 2. Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*"

sqaron se, përgatitja e kritereve teknike është detyrë e njësisë së prokurimit. Nga ana e grupit të punës eshte përcaktuar struktura e stafit të IP, profili dhe kualifikimet dhe kufiri minimal i eksperiencës profesionale.